

LIGJ
Nr.9361, datë 24.3.2005

**PËR NJË TRAJTIM TË VEÇANTË FINANCIAR TË EFEKTIVAVE, OFICERË DHE
NËNOFICERË LUNDRUES, TË NËNDETËSEVE DHE POLUMBARËVE TË FORCAVE
DETARE, NË PENSION**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është të rregullojë trajtimin financiar të efektivave, oficerë dhe nënoficerë lundrues, të nëndetëseve e të polumbarëve, që kanë shërbyer në strukturat e Forcave Detare të Republikës së Shqipërisë, në shtesë të pensionit të pleqërisë, të cilin e përfitojnë nga sigurimi shoqëror i detyrueshëm, në çastin e lindjes të së drejtës së përfitimit të këtij trajtimi.

Neni 2
Baza e llogaritjes

Paga referuese është bazë për llogaritjen e këtij trajtimi të veçantë financiar.

Me pagë referuese, për efekt të këtij ligji, kuptohet paga bazë për funksionin plus shpërblimin për gradë sipas viteve të shërbimit, të njësuar me pagën e ushtarakut të së njëjtës gradë, në çastin e lindjes të së drejtës për trajtim të veçantë financiar.

Neni 3
Financimi dhe llogaritja e përfitimit

Efektet financiare, që rrjedhin nga ky ligj, përballohen nga Buxheti i Shtetit.

Pagesa dhe caktimi i përfitimeve, që rrjedhin nga ky ligj, bëhen nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore.

Mënyra e llogaritjes së përfitimeve përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 4
Kushtet e përfitimit

Efektivat lundrues, oficerë dhe nënoficerë, të cilët kanë shërbyer në nëndetëse dhe të polumbarëve, oficerë dhe nënoficerë, të Forcave Detare, të cilët kanë plotësuar ose plotësojnë kushtet për pension pleqërie, përfitojnë, përveç pensionit të pleqërisë, një trajtim financiar në masën:

- a) 50 për qind të pagës referuese, kur kanë shërbyer jo më pak se 12,5 vite kalendarike;
- b) 30 për qind të pagës referuese, kur kanë shërbyer jo më pak se 10 vite kalendarike;
- c) 20 për qind të pagës referuese, kur kanë shërbyer jo më pak se 7 vite kalendarike.

Neni 5
Shuma e pensionit

Shuma e pensionit të plotë të pleqërisë plus masën e trajtimit të veçantë financiar, sipas këtij

ligji, nuk mund të jetë më e madhe se 50 për qind e pagës referuese të oficerit dhe nënoficerit të nëndetësës dhe të polumbarit në çastin që i ka lindur e drejta e përfitimit.

Masa e trajtimit të veçantë financiar indeksohet sa herë që indeksohen pensionet e pleqërisë.

Neni 6

Njësimi i funksioneve

Kur funksionet organike, në çastin kur oficerët dhe nënoficerët e nëndetësëve dhe polumbarët kanë dalë në rezervë, në lirim ose në pension pleqërie, nuk ekzistojnë më në strukturën e Forcave të Armatosura, Ministri i Mbrojtjes, për efekt të pagës referuese, bën njësimin e funksionit dhe të gradës së tyre me funksionet organike, që ekzistojnë në Forcat e Armatosura, në çastin kur ushtarakut i lind e drejta e përfitimit të këtij trajtimi.

Neni 7

Dispozita kalimtare

Personave, që u lind e drejta për përfitimin e trajtimit të veçantë financiar, sipas këtij ligji dhe që njëkohësisht përfitojnë edhe nga neni 12 i ligjit nr.8087, datë 1.3.1996 "Për sigurimin suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura në Republikën e Shqipërisë, të ushtarakëve të Ministrisë së Rendit Publik dhe të Shërbimit Informativ Shtetëror", kanë të drejtë të zgjedhin ndërmjet trajtimit të veçantë dhe pensionit suplementar të pleqërisë.

Neni 8

Nxjerrja e akteve nënligjore

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të nenit 3 të këtij ligji.

Neni 9

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.4535, datë 13.4.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë
Alfred Moisiu**